

V E N D I M
Nr. 355, datë 27.5.2001

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË KONCENSION TË HIDROCENTRALEVE
VENDORE**

(Ndryshuar me VKM nr. 181, datë 3.5.2002)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 5 dhe 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” dhe të nenit 2 të ligjit nr.8527, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave të privatizimit në formë koncensionit të 31 hidrocentraleve vendore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, me shoqërinë “VEVE & ESSEGEI”, sipas ofertës së pakërkuar.

2. Forma e kontratës koncensionare të jetë ROT (rehabilitim, operim, transferim)

3. Organi i autorizuar shtetëror për negocimin dhe për nënshkrimin e kësaj kontrate, të jetë *Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë.*

4. Ngarkohet *Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Nr.	Emërtimi	Rrethi	Kapaciteti aktual (kW)
1	Shoshan	Tropojë	230
2	Orgjost	Kukës	400
3	Lenie	Gramsh	400
4	Lozhane	Korçë	145
5	Lek-Bibaj	Tropojë	400
6	Arras	Dibër	1200
7	Dukagjin	Shkodër	640
8	Lurë	Dibër	400
9	Lunik	Librazhd	200
10	Homezh	Bulqizë	150
11	Xhyrrë	Librazhd	250
12	Treskë 2	Korçë	130
13	Tuçep	Bulqizë	400
14	Funares	Librazhd	1040
15	Vithkuq	Korçë	720
16	Nikolic	Korçë	500
17	Bulqizë	Bulqizë	400
18	Velçan	Korçë	320
19	Zerqan	Bulqizë	250
20	Borsh	Sarandë	250
21	Leshnicë	Sarandë	250

22	Martanesh	Mat	240
23	Ujanik	Skrapar	220
24	Kërpic	Gramsh	200
25	Barmash	Kolonjë	200
26	Voskopojë	Korçë	200
27	Piqerras	Sarandë	200
28	Çorovodë	Skrapar	200
29	Muhur	Dibër	200
30	Rajan	Kolonjë	200
31	Marjan	Korçë	200

Për VEVE Engineering & Consulting sh.p.k.
Rudolf Papa

Drejtör

Për ESSEGEI sh.p.k.
Viktor Hykollari

Përfaqësues i autorizuar